



SHOQATA KOMBËTARE E GRUAS PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE

Veprimtarë ruralë & urbanë transformojnë jetën e GRAVE

Nga Flutura Xhabija

Më 5 mars 2018, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, u mbajt në hotel Mondial në Tiranë, Konferenca "Veprimtarë ruralë & urbanë transformojnë jetën e GRAVE". Ky aktivitet u organizua me iniciativë të



presidenteve të 4 shoqatave OJF si: Shoqata e Gruas Profesioniste & Afariste, (SHGPAZ); Në Dobi të Gruas Shqitare; Shoqëria Shqiptare për të gjitha Moshat (ASAG) dhe

Shoqata për gratë & fëmijët.

Mesazh ishte i qartë. Shoqëria civile është një forcë e fortë për transformimin e mentalitetit shqiptar dhe për fuqizimin ekonomik të gruas.

Koha është tani! Ekspertë dhe politikbërës mbledhuni rreth këtyre shoqatave për të vepruar sa më parë!



Buletin Informativ

Mars 2018

NË KËTË NUMËR

Vetëvlerësimi i SBA, për politikat për mbështetjen e gruas sipërmarrëse

Më 16 mars 2018, nën drejtimin e ETF u mbajt takimi për diskutimin rreth vetëvlerësimit të politikave për gruan sipërmarrëse. Faqe 7



Unioni ballkanik i grave zejtare! Platforma 2018-2023

Më datë 14-15 mars 2018, u mbajt në Sofie të Bullgarisë takimi për diskutimin e Platformës 2018-2023 Faqe 5



Forumi i 2-të kombëtar i grave Frankofone Shqiptare

Më 6 mars 2018 u mbajt në Tiranë Forumi i 2-të kombëtar i grave Frankofone Shqiptare për të promovuar dialogun dhe shkëmbimet e ideve mbi barazinë gjinore, në kuadër të fuqizimit ekonomik të gruas, formimit profesional dhe ndihmës ndaj sipërmarrjes femërore. Merrnin pjesë Znj. Christina Vasak, Ambasadore e Francës në Shqipëri, si dhe Ministria e Shëndetësië znj. Ogerta Manastirliu.

SHGPAZ u përfaqësua me disa anëtare sipërmarrëse frankofone.



Konkursi IDEA për plane biznesi 15 janar deri 15 mars 2018



Konkursi **IDEA** për plane biznesi, faza e aplikive u mbyll më

datë 15 mars 2018.

Tani vazhdon faza e përzgjedhjes dhe e asistencës së mëtejshme për aplikantët e përzgjedhur.

Ky konkurs mbështet të rinjtë që kanë një ide biznesi ose drejtojnë një biznes prej më pak se 3 vjet.

Konkursi IDEA ofron një paketë të plotë mbështetjeje nëpërmjet seancave tërheqëse të trajnimit, coaching/këshillim, mentorim dhe fituesve do t'u ofrohet grant.

Linku i IDEA në facebook:

www.facebook.com/ideaalbania

Afati i aplikimit ishte deri në datën **15 Mars 2018**.

Bankat dhe biznesi

Ndryshimet në strukturën e kredisë


Zhvillimet ndër vite në portofolin e kredisë të bankave tregojnë se aktiviteti kreditues është rritur me ritme të shpejta në periudhën e parakrizës,

më pas është ngadalësuar dhe tkurrur në vitet mbas krizës, për të shfaqur shenjat e para të rigjallërimit në vitin e

fundit. Kjo sjellje ka reflektuar si dinamikën ekonomike ashtu dhe zhvillimet strukturore të sektorit financiar. Gjatë kësaj periudhe janë vënë re edhe ndryshime strukturore të portofolit të kredisë pothuajse në të gjitha nën segmentet e tij.

Portofoli i kredisë bankare ka qenë gjithmonë i dominuar nga kreditimi i bizneseve. Në ndryshim nga vendet e zhvilluara ku bizneset kanë si burim të rëndësishëm financimi tregun e kapitaleve, në vendet në zhvillim dhe në veçanti në Shqipëri, sistemi bankar përbën burimin kryesor të financimit. Gjatë viteve 2003-2008, kredia për biznese përjetoi rritje të shpejtë, kryesisht për biznesin e madh dhe në valutë. Rritja e kredisë në valutë u përqendrua në rritjen e kreditimit në euro e mbështetur jo vetëm nga kërkesa e lartë e sektorëve

me veprimtari në valutë, por edhe nga oferta e bankave. Në periudhën mbas krizës, kredia për biznese shfaqti ngadalësim të



shpejtë të normave të rritjes, duke u pozicionuar në nivele të moderuar, të mbështetura nga rritja e kredisë në lekë për biznese që kompensonte tkurrjen e kredisë në valutë. Një tipar tjetër i zhvillimeve të kreditimit të bizneseve në periudhën pas krizës, ka qenë përqendrimi i ofertës për kredi vetëm në pak banka të sistemit dhe në shuma të vogla i ndikuar nga rreziku i lartë i kredisë.

Gjatë periudhës së rritjes së shpejtë të kredisë 2003-2008, bankat rritën me shpejtësi kredinë për individë. Veçanërisht gjatë kësaj periudhe ato u fokusuan në prezantimin e produkteve me kushte atraktive të kreditimit për blerjen e banesave, të cilat dominuan dhe rritjen e portofolit të individëve në këtë periudhë. Ofertat e

bankave u shoqëruan nga një kërkesë e lartë e individëve për financim në përgjigje të nevojave për përmirësimin e kushteve të banimit dhe cmimeve të banesave në rritje. Në fund të vitit 2007, segmenti i kredisë për individë shënoi peshën më të lartë historike në portofol, me 37.2% të kredisë totale.

Menjëherë mbas krizës financiare të vitit 2008, kredia për individë u tkurr me shpejtësi dhe pesha e saj në totalin e kredisë ka qenë përgjithësisht në rënie. Këto zhvillime

reflektuan si shtrëngimin e ndjeshëm të standardeve të kreditimit ashtu edhe hezitimin e individëve për të kërkuar kredi. Kjo ecuri duket sikur ka ndryshuar që prej vitit 2015 dhe në vazhdim. Në tre vitet e fundit, normat e rritjes së kredisë për individë janë vendosur në një trajektore rritëse duke shënuar mesatarisht rreth 5%.

Në fund të vitit 2017, kredia për individë shënoi rritje në 33.2% të kredisë për sektorin privat. Zhvillimet pozitive të portofolit të kredisë së individëve në këtë periudhë janë mbështetur më së shumti nga rritja e shpejte e kredisë konsumatore, kurse kredia për banesa shfaqet me ritme rritjeje të përmbajtura.

Njoftim i Tatimeve:

Biznese, dorëzoni deri në fund të marsit 2018 deklaratën e pagesës së tatimit fitimit dhe pasqyrat financiare për vitin fiskal 2017

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u kujton bizneseve detyrimin për dorëzimin brenda datës **30 mars** të deklaratës së pagesës së tatimit fitimit dhe pasqyrave financiare për vitin fiskal 2017.

Tatimpaguesi duhet të dorëzojë, formularin e Deklarimit të Tatimit mbi Fitimin sipas modelit të miratuar me udhëzim. Ky formular plotësohet në përputhje me shënimet sqaruese dhe dorëzohet vetëm elektronikisht



në administratën tatimore, bilancin kontabël së bashku me pasqyrat financiare dhe anekset e tij si: -Bilanci; -Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve; - Pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të parasë ose pasqyra e qarkullimit të likuiditeteve (cash-flow); -Aneksi për shpjegimet shpjeguese; - Raporti i ekspertit të autorizuar të shoqërisë (kur ky raport kërkohet në zbatim të legjislacionit). Për informacion dhe asistencë, ata që kanë detyrimin e deklarimit, mund t'i drejtohen sporteleve të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në të gjithë vendin ose të **telefonojnë në numrin pa pagesë të Qendrës së Thirrjeve 0800 00 02.**

Biznese Nxitoni!

Takim i NBF dhe Vizitë në një biznes fason në Tiranë



Takimi i radhës i Forumit Kombëtar të Biznesit (NBF) u mbajt më datë 6 mars 2018, në ambjentet e një biznesi fason të veshjeve në periferi të Tiranës, të drejtuar nga Gjergji Gjika. Ambjentet moderne, kushte të mira si: paga mjaft e mirë, dreka e porositur, shërbim shëndetësor dhe trajnime profesionale falas! Kjo si dhe puna me cilësi e vajzave dhe grave të zonës kontribuojnë në prodhimet me cilësi për eksport, gjë ka sjell rritjen e mëtejshme të kërkesës për këto prodhime nga vendet e BE-së.

Unioni ballkanik i grave zejtare! Platforma 2018-2023

Më datë 14-15 mars 2018, u mbajt në Sofie të Bullgarisë **Unioni ballkanik i grave zejtare**, për hartimin dhe diskutimin e Platformës 2018-2023 të unionit. SHGPAZ u përfaqësua me presidenten znj. Flurura Xhabija dhe me dy anëtare të tjera të bordit drejtues.



Draft strategjia pesëvjeçare e unionit është hartuar konform atyre evropiane dhe globale! Integrimi i vendit tonë edhe në këtë fushë është i vështirë, sepse jemi vetëm, ndërsa shtetet e tjera suportohen nga shteti e politika. Rezistenca jonë gjatë dekadave ka qenë persistente dhe e përkushtuar, por nuk mjafton. Vëmendje e politikbërësve për të mbështetur këto shoqata që përpiqen pafund për forcimin ekonomik të grave.



Strategjia e bashkëpunimit zvicerian 2018-2021

Bashkëpunimi vazhdon! Më datë



7 mars 2018 u lançua Strategjia e Bashkëpunimit Zviceran për 2018 – 2021 me një buxhet 90 million Euro. "Bashkëpunimi ndërkombëtar zviceran gjen këtu terren pjellor për aktivitetin e tij", tha Sekretarja Zvicerane e Shtetit

për Çështje Ekonomike Marie-Gabrielle Ineichen-Fleisch. Zv. Kryeministrja e Shqipërisë Senida Mesi dhe Ambasadori Graf theksuan dhe lëvduan lidhjet miqësore midis dy vendeve. Lexoni më shumë:

<https://tinyurl.com/yafwzueX>

RCC në 10 vjet koordinim rajonal

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) me sekretariat në Bosnje & Herzegovinë, festoi 10 vjetorin e krijimit të saj, si një nga insituconet rajonale të SEE efektive dhe me rezultate konkrete.

Së fundmi stafit të këtij insitucioni i është bashkuar edhe znj. **Pranvera Kastrati**, në pozicionin e ekspertes së integritit rajonal. Znj. Kastrati është një nga ekspertet më të mira të Shqipërisë, por jo vetëm, në lidhje me politikat tregtare, të integritit rajonal e të CEFTAs. I urojmë Sukses!



e-Albania

Ofron 14 shërbime të reja

nga Violeta Shqalsi

Portali qeveritar e-Albania së shpejti do të zgjerojë gamën e shërbimeve të ofruara për qytetarët. Kështu nëpërmjet portalit në rubrikën "e-Pagesat", qytetarët mund të paguajnë faturat e energjisë elektrike, gjobat për kundërvajtje rrugore, taksat e automjeteve, e deri te aplikimi për leje qarkullimi ndërkombëtare. Gjithashtu nëpërmjet shërbimeve të reja qytetarët e Durrësit si dhe bizneset që operojnë në këtë qytet mund të paguajnë taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Durrës. Sipas listës së publikuar nga e-albania, në total janë 14 shërbime të reja, siç tregon tabela më poshtë:

Punësimi

nga Violeta Shqalsi

Në muajin Mars janë punësuar 1,396 persona, të cilët i janë drejtuar për një vend pune Zyrave Kombëtare të Punësimit dhe deri në fund të vitit, synohet të arrihet në 25 mijë.

Rezultatet janë marrë nga Drejtoria e Përgjithsme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, sipas së cilës, të dhëna tregojnë një tendencë në rritje, dhe së në muajt në vijim rezultatet do të jenë edhe më të larta.

"Objektivi i zyrës së punësimit për vitin 2018 është punësimi i 25 mijë personave, si dhe aftësimi profesional minimalisht për **10 mijë të rinj** që dalin nga skema ekonomike.



Sfidat janë të mëdha, në këshillim, në ndërmjetësim, do kemi trajnime të herë pas herëshme që zyrat të bëjnë punën akoma më mirë. Është e rëndësishme që punëkërkuarit të drejtohen në institucionet e duhura, ku do të marrin mbështetje dhe orientim drejt tregut të punës".

Qeveria ka vendosur se të gjithë ata që dalin nga ndihma ekonomike do të kenë përparësi në punësim.

Gjithashtu të papunët do të përfitojnë edhe nga programi i pagesës së papunësisë që qeveria ka miratuar së fundmi. Ajo do të jetë 50% e pagesës minimale, pra në vlerën e 12 mijë lekëve. Nga ana tjetër personat që dalin nga skema ekonomike do të marrin një fond prej 5,5 mijë lekësh për aftësim në zyrat e shërbimit profesional.



FAKTE

26.8%

Biznese aktive të drejtuar/pronare gra, për vitin 2016 në Shqipëri rezultojnë 26.8% me një rënie me 4.5 pikë % në krahasim me vitin 2015 ku përbënin 31.3%. (INSTAT)



3.2%

Kredia për vitin 2017 rezulton me një rritje modeste me vetëm 3.2% krahasuar me një vit më parë dhe zë 36,5% ndaj PPB, me një ulje prej 1 pikë përqindje krahasuar me 2016. (Banka e SHqipërisë)



Debat televiziv më 8 mars 2018

Me rastin e Ditës Kombëtare të Gruas u zhvillua një debat televiziv në scan TV në lidhje me pozicioni që zen gruaja sot në shoqërinë shqiptare dhe kontributin që jep në zhvillimin ekonomik të vendit.

Gratë në biznes u përfaqësuan me presidenten e SHGPAZ znj. Flutura Xhabija. Arritje dhe kritika që mund të behet më tepër për fuqizimin e mëtejshëm të gruas.



Vetëvlerësimi i SBA, për politikën për mbështetjen e gruas sipërmarrëse

Më datë 16 mars 2018, në Hotel Tirana u



zhvillua takimi për të diskutuar masat dhe politikën e ndërmarra nga qeveria për mbështetjen e gruas

sipërmarrëse. Ky takim u zhvillua nga ETF dhe Ministria e Ekonomisë & Financave, në kuadër të vetëvlerësimit të masave për dimensionin 1b të monitorimit të Small Business Act (SBA).

Nga presantimet doli se vlerësimi i vitit 2016 rezultonte me rënie në krahasim me atë të vitit 2013, ndërsa vlerësimi paraprak për vitin 2018 rezulton me rënie në krahasim me atë paraardhës, gjë që tregon se edhe se janë hartuar strategji e plane veprimi për fuqizimin e gruas sipërmarrëse, shumë pak është bërë në zbatimin e tyre dhe aq më pak është impakti në sipërmarrjen femërore.

Politikbërës kushtojni vemëndjen e duhur fuqizimit të gruas sipërmarrëse!

Gruaja dhe shëndeti

Antidepressivët në shtatzëni, si dhe ushqimet që e luftojnë depresionin

Materiale të përpunuara nga **Arlinda Demeti**

Gjithnjë ka pasur debate rreth përdorimit të ilaçeve antidepressive në shtatzëni, duke përhapur dilemën se ato e ulin inteligjencën te fëmija që do të lindë. Por duket se gjithçka është një mit fals dhe ulja e inteligjencës ka të tjerë shkaktarë.

Sipas një studimi të kryer nga Aleksandër Viktorin et al. nga Icahn School of Medicine në Mount Sinai në New York dhe i publikuar në revistën shkencore JAMA Psichiatri, tregohet se nuk ka asnjë lidhje domethënëse midis aftësisë së kufizuar intelektuale të fëmijve dhe përdorimit të antidepressivëve gjatë shtatzënisë. Aftësia e kufizuar intelektuale i atribuohet shpesh faktorëve gjenetikë dhe ambientale, mes të cilëve faktorët e trashëgueshëm, faktorët që ndikojnë në zhvillimin e fetusit, apo agjentët toksikë.

Në studimin e mësipërm janë përfshirë 179,007 fëmijë të lindur gjatë vitit 2007, duke marrë të dhënat nga regjistrat kombëtar

suedez. Rezultatet e studimit kanë treguar se aftësia e kufizuar intelektuale është diagnostikuar vetëm në 37 (0.02%) fëmijë të ekspozuar ndaj antidepressivëve në krahasim me 819 (0.5%) që nuk ishin ekspozuar.

Mesazhi i studimit për mjekët është se edhe nëse ekziston një lidhje midis përdorimit të antidepressivëve në shtatzëni dhe aftësisë së kufizuar intelektuale te fëmijët, në veçanti për inhibitorët selektivë të ripërthithjes së serotoninës, ka gjasa që kjo të mos jetë shkakuar nga vetë medikamenti, por nga karakteristika të tjera të prindërve si: histori të çrregullimeve psikiatrike, moshë më e avancuar e nënave apo baballarëve dhe çrregullimeve psikiatrike të nënës para shtatzënisë.

Rekomandohet që jo vetëm gratë shtatzëna, por edhe personat e tjerë, të përdorin në dietën e tyre ushqime antidepressive si:

Avokado. Avokadot përmbajnë shumë kalium – 485 mg per 100 gram avokado. Kjo është e mrekullueshme për shkak se një dietë e lartë kaliumi është e njohur për efektin për të lehtësuar simptomat e depresionit dhe stresit. Një i rritur duhet të marrë 4700 mg kalium në ditë. Një avokado gjatë



ditës është një mënyrë e shkëlqyer për ta luftuar depresionin.

Çaji gjelbërt – (Camellia sinensis foliage). Njerëzit kanë përdorur çajin e gjelbërt për të luftuar depresionin për mijëra vjet. Sipas hulumtimeve, polifenolet që ndodhen në çajin e gjelbërt nxisin furnizimin e trurit me dopamine, një neurotransmetues i lumturisë. Këto polifenole të mrekullueshme mjaft të dobishme punojnë gjithashtu për të rritur ndjeshmërinë e insulinës dhe mbajnë një furnizim të qëndrueshëm të glukozës në tru. Doza ditore: merrni deri katër gota në ditë nga 250 ml.

Bajamet. 100 gram bajame përmbajnë 268 mg magnez. Magnezi punon për mrekulli për trajtimin e depresionit si dhe të migrenës. Gratë kanë nevojë për 320 deri 500 mg në ditë. Rekomandimi: hani një grusht bajame çdo ditë dhe ju do të jeni tashmë mirë në rrugën tuaj kundër depresionit.

Të tjera ushqime që rekomandohen janë: **thjerrëzat, fasulet, qiqrat, peshku Salmon, çokollata e zezë, bananet, boronicat, spinaqi.**



Drita Cacaj zë i shqiptarëve në parlamentin austriak

Shqiptarja nga Deçani, Drita Cacaj, pjesë e listës zgjedhore të ÖVP-së (Partia Popullore Austriake), vendosi që më 15 tetor 2017 t'i drejtohej elektoratit (për të dytën herë) për të kërkuar besimin për të hyrë në mesin e 100 deputetëve të parlamentit austriak. Drita Cacaj, edhe pse ishte vetëm 3 vjeçe kur emigroi me prinderit e saj në Austri para 49 vitesh, ajo e flet bukur dhe e zotëron për mrekulli gjuhën amtare shqipe.

Ajo tashmë është në moshën 52 vjeçare, njohëse e mirë e shumë gjuhëve të huaja si rezultat i studimeve të shkëlqyera në

Universitetin e Vjenës dhe përvojës së punës si përkthyes në institucionet zyrtare austriake.

Me përvojën e saj mbi 10 vjeçare në skenën politike dhe bagazhin e pasur intelektual, ajo garoi përkrah kandidatit Sebastian Kurz, ish-ministër aktual i Punëve të Jashtme të Austrisë.

Drita Cacaj synon mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Austri, për integrimin e përgjithshëm të shqiptarëve, në veçanti për mbrojtjen e të drejtave të grave, nënave dhe motrave shqiptare.

Ajo ka një përvojë mbi 10 vjeçare në politikë, është një kapital i çmueshem, një vlerë që duhet mbështetur pa rezervë nga të gjithë shqiptarët në Austri.



Drita Cacaj me autoritetin e saj gëzon mbështetje nga komuniteti shqiptar në Austri, në radhë të parë nga Fondacioni "Dukagjini" me seli në Vjenë si dhe shumë shoqata e organizime të tjera gjithandej shtetit austriak.

Një shembull i mirë për t'u ndjekur edhe nga intelektualë të tjerë!

Suksese!

Buletin Informativ

Mars 2018



Rr.Mujo Ulqinaku,
Pall.Kristian Konstruktion,
kati 1, ap.9 Tirana-Albania
phone/fax:00355 4 2235726
mob.0682763344, 069257242
info.shgpaz@yahoo.com

Pergatiti
Msc. Flutura XHABIJA &
Redaksia

Kalendari i Panaireve në Poloni Prill-Maj 2018

Month	Event Name	Dates	Description
APRIL	 ANIMALS DAYS	06-08.04.2018	Animals Days
	 ictlive IT&MOBILE	12-14.04.2018	ICT Live - IT & Mobile Expo
	 ELECTRONICS SHOW	12-15.04.2018	ELECTRONICS SHOW - Central European Smart Electronics Show by Saturn
	 GOOD GAME	20-22.04.2018	Good Game
	 Warsaw Comic Con	20-22.04.2018	Warsaw Comic Con
MAY	 Warsaw Oldtimer SHOW	12-13.05.2018	Classic Cars Fair and Auction
	 GO ACTIVE SHOW	18-20.05.2018	Fitness and Strength Sports Fair
	 Bio CONTRACTING	18-20.05.2018	Bio CONTRACTING - Ecological Industry Fair
	 FOOD EXPO	24-26.05.2018	Warsaw Food Expo